


📁 Projekti “Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Integruar (PMI) për Qendrat Historike Berat – Gjirokastrë”



Buxheti:	30,460 \$
Periudha e zbatimit:	Janar 2021 – Dhjetor 2022
Investitori:	UNESCO nëpërmjet Financimit për Projekte me Asistencë Ndërkombëtare.
Përfitues:	MK, IKTK, Bashkia Berat, Bashkia Gjirokastrë
Zbatues:	IKTK
Objektivat e Projektit:	Objekti i këtij projekti është të zhvillojë një mjet të integruar të konservimit dhe zhvillimit urban, bazuar në një studim të detajuar dhe dokumentacion të ndërtimeve dhe karakteristikave mjedisore në qendrat historike urbane të Gjirokastrës dhe Beratit, duke përdorur qasjen e Rekomandimit për Peisazhin Historik Urban - HUL, si dhe të sigurojë bashkëpunim të fortë ndërinstitucional dhe përfshirjen e komunitetit lokal.

Në kuadrin e vendimeve të vazhdueshme të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, në lidhje me nevojën urgjente të një Plani Menaxhimi të Integruar - PMI për Pronën Pasuri Botërore “Qendrat Historike të Gjirokastrës dhe Beratit”, nga ana e IKTK-së në vitin 2017 u aplikua për asistencë ndërkombëtare me financim të UNESCO. Asistenca Ndërkombëtare Nr. 2932 mbi *“Zhvillimin e Planit të menaxhimit të integruar për Qendrat Historike Berat – Gjirokastrë”* u aprovua nga Qendra e Trashëgimisë Botërore (QTB) në vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 IKTK-ja ka dakordësuar termat e kontratës me vlerë **30,460\$** dhe ka firmosur kontratën me QTB-në. Projekti zhvillohet gjatë vitit 2021 dhe përfshin përveç angazhimit të 3 ekspertëve ndërkombëtarë nga ICOMOS dhe ICCROM, të cilët janë kontraktuar nga QTB-ja dhe angazhimit të shtetit palë.

Hartimi i këtij Plani të Menaxhimit të Integruar kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve dhe institucioneve që lidhen me dy qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë dhe ndihmën ndërkombëtare të ekspertëve në këtë fushë. Në mënyrë që të bashkërendohen të dhënat nga disa institucione lokale, rajonale dhe kombëtare do të kryhen në terren vizita brenda sitit të Trashëgimisë Botërore të Gjirokastrës dhe Beratit dhe takime e workshop-e, në mënyrë që të ndërmerren veprime dhe afate të përcaktuara nga të gjitha institucionet përgjegjëse sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.

Digjitalizimi i Arkivës teknike të IKTK-së



Buxheti:	80,000 \$
Periudha e zbatimit:	2020 në proces
Investitori:	Qeveria Zviceriane, në kuadër të Fondit të Emergjencës për Trashëgiminë
Përfitues:	IKTK-ja
Autoritet Kontraktor:	UNESCO Venice Office – Zyra e UNESCO-s në Venecia
Objektivat e Projektit:	Objektivi i përgjithshëm i projektit është ruajtja dhe digjitalizimi i dokumentacionit dhe materialeve arkivore në një sistem të integruar përmes skanimit me cilësi të lartë, katalogimit në databazë të personalizuar dhe ruajtjes në servera të posaçëm.

Arkivi Kombëtar Teknik i IKTK-së mban çdo dokument të përgatitur ndër vite për monumentet dhe sitet e trashëgimisë kulturore në territorin e Shqipërisë. Si rrjedhojë, ai është një pjesë integrale e historisë së këtyre monumenteve dhe si e tillë mbart një vlerë të pazëvendësueshme historike. Çdo projekt restaurimi përfshin gjithashtu një studim të punëve të mëparshme të ruajtjes dhe restaurimit të ndërmarra në ndërtesë / sit / objekt dhe Arkivi Teknik Kombëtar është ndalesa e parë për përgatitjen e studimeve të tilla.

Në përputhje me qëllimet e ruajtjes dhe qasjes në Arkivin e IKTK-së, materialet origjinale duhet të digjitalizohen për një larmi arsyesh, kryesisht duke synuar ruajtjen më të mirë të kopjeve origjinale, por gjithashtu për lehtësimin e procesit të punës së përditshme të stafit të IKTK-së dhe institucioneve të tjera të specializuara në varësi të Ministrisë së Kulturës. Epoka digjitale hap mundësi të reja për studiuesit dhe publikun e interesuar për të mbledhur informacion në lidhje me monumentet historike, arkitektonike dhe artefaktet. Këto dokumente mund të shërbejnë si fakte historike mbi mënyrën e ndërtimit të shqiptarëve gjatë gjithë historisë dhe të japin informacione të rëndësishme në lidhje me dimensionet / përmasat, materialet historike të ndërtimit, teknologjinë e përdorur etj ...). Këto dokumente, që i përkasin trashëgimisë kulturore kombëtare, duhet të ruhen ndoshta "përgjithmonë".

Arkivi teknik kombëtar, përmban:

- dosje teknike ku përfshihen skica dhe projekte teknike, raporte dhe relacione teknike, preventiva, harta me formate të madhësive të ndryshme nga A4, deri në formate jashtë standartit A0 +;
- ekzistojnë gjithashtu rreth 47,700 filma dhe mikrofilma negativë që ruhen në formate dhe dimensione të ndryshme;
- rreth 256,200 fotografi me ngjyra dhe bardh e zi në formate të ndryshme;
- gjithashtu rreth 28,500 diapozitivë të formateve të ndryshme bardh e zi dhe me ngjyra.

Qasja drejt Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në sigurimin e shërbimeve elektronike përcaktohet si një nga përparësitë kryesore të Ministrisë së Kulturës.

IKTK-ja është përfituese e projektit *“Digjitalizimi i arkivit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokolli për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence”*, i cili financohet nga Qeveria Zviceriane, në kuadër të Fondit të Emergjencës për Trashëgiminë. Fondi menaxhohet dhe prokurohet nga zyra e UNESCO-s në Venecia me koordinimin e IKTK-së.

IKTK-ja është angazhuar për përgatitjen e materialeve bazë mbi raportin e gjendjes ekzistuese të arkivës dhe nevojave, legjislacionit përkatës, termat e referencës për pajisjet e nevojshme dhe termat e referencës për hartimin e databazës. Aktualisht janë blerë pajisjet për procesin e digjitalizimit, pajisje të cilat kompletojnë sektorin e arkivës teknike të IKTK-së, si dhe është realizuar aplikacioni “soft” i databazës së arkivit.

Vijon puna nga ana e stafit të IKTK-së për digjitalizimin e Arkivit Teknik.